

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Robox”

Sot, më datë 20/08/2025 (dymijë e njëzetë e pesë), i pranishëm:

- **Z. Sildi Caushi**, shtetas shqiptar, lindur më 30/09/1995 në Tiranë dhe me banim në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. BB4225766 dhe me numër personal J50930068V, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

në cilësinë e ortakut të vetëm themelues, shpall hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akt Themelimi në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me termat si më poshtë vijon:

NENI 1
EMËRTIMI

Themelohet një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“Robox”**

NENI 2
SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rruga e Kavajes, Pallati Milo 2000, Nr:1 (perballe Fabrikes se Birres) 1000, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve, mund të hap seli dytësore, filiale, zyra përfaqësimi, degë ose agjensi si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin e Shoqërive Tregëtare deri sa të mbyllet me akte ligjore.

NENI 4
OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së studios është:

1. Zhvillim Softi & Aplikcionesh.
2. Sisteme CRM & ERP.
3. Robot për restorante, dyqane & hotele. Robot kamarier që shërbejnë në restorante/hotel. Robot për dyqane, depo, ose shpërndarje. Lidhen me kasat ose sistemet ekzistuese (POS/CRM), instalime, trajnime dhe servise.



4. Soft i gatshëm (gati për përdorim) Menaxhim stokesh & magazinash. Rezervime me orare Online. Soft për kontrollin e orarit të stafit. Chatbot dhe asistencë virtuale për klientët. Menaxhin dyqanesh online dhe shitje.
5. Konsulencë & Suport Teknik. Strategji për automatizim & dixhitalizim. Lidhje sistemesh bashkë, që të funksionojnë si një e vetme. Mirëmbajtje mujore dhe suport teknik. Optimizim i teknologjisë aktuale.

Gjithashtu për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti që përfshihet apo që mund të shtohet/pakësohet në objektin e saj që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 ALL (një qind lekë) dhe është i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100 ALL (një qind lekë).

Kapitali themeltar zotërohet totalisht nga ortaku i vetëm **Z. Sildi Caushi**, shtetas shqiptar, lindur më 30/09/1995 në Tiranë dhe me banim në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. BB4225766 dhe me numër personal J50930068V, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Organi Administrativ. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë dhe vepron në përputhje me statutin e shoqërisë dhe ligjet në fuqi.

Organi i vetëm Administrativ i shoqërisë është Administratori i saj i vetëm:

- **Z. Sildi Caushi**, shtetas shqiptar, lindur më 30/09/1995 në Tiranë dhe me banim në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. BB4225766 dhe me numër personal J50930068V, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

që do të qëndrojë në detyrë për një periudhë prej 5 vjetësh me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, në përputhje me sa parashikohet nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga statuti i shoqërisë. Administratori ka të drejta dhe kompetenca të plota për kryerjen e të gjitha veprimeve që do të konsiderojë të dobishme për realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që kërkojnë miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, në gjykatë si dhe përpara organeve shtetërore dhe private.



NENI 7
PJESËMARRJA NË SHOQËRI TË TJERA

Ortakët mund të vendosin lirisht pjesëmarrjen në shoqëri të tjera si dhe të fillojnë çdo lloj aktiviteti tjetër tregtar në territorin e Shqipërisë, me kushtin që të mos jetë konkures me atë të shoqërisë së themeluar prej tij.

Çdo veprimtari që bie ndeshë me paragrafin e sipërpërmendur nuk do të konsiderohet si konflikt interesi nëse merr votbesimin e të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të ortakëve. Do të konsiderohen të përjashtuara nga kufizimi i mësipërm marrëdhëniet dhe veprimtaritë tregtare që mund të ushtrohen prej ortakëve jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 8
LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor e Juridksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 10
DISPOZITA FINALE

Ky akt themelimi u hartua në kater kopje të njëjta në gjuhën shqipe, u lexua e u pranua nga ortaku i shoqërisë, i cili e nënshkruan për të gjitha efektet e ligjit.

ORTAKU THEMELUES

Sildi Caushi

Sildi Caushi 